




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality Skenderaj

### Kuvendi i Komunës/Skupština Opštine/Municipality of Assembly

Në bazë të nenit 43, të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040, të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 37 paragrafi 1,3 të Statutit të Komunës së Skenderajt nr.01-110-385 të dt.03.12.2008, Rregulloren e punës së Kuvendit nenit 27, e në pajtim me rregullat e procedurës.

Ekstrat nga procesverbali i mbledhjes së KOMITETI PËR POLITIK E FINANCAT, i mbajtur me datë 21.02.2024, në ora 14:00, në sallën e bordit të drejtoreve.

#### **Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:**

1. Fjala hyrëse;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluara;
4. Informatë lidhur me ndryshimet në Zyrën Kadastrale, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër e Pronësi, Nr.05-020/01-0009631/24, datë 13.02.2024, (Raporton Drejtoresha e DGJKP-së, **znj. Blerta Dobra-Geci**);
5. Të ndryshme.

**Kryesuesja:** Të nderuar anëtar KPF-së, Kryetar i komunës, drejtor të drejtorive, në këtë mbledhje i kemi 5 anëtarë të KPF-së,

-Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës, e hapë debatin, nëse nuk ka, konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Rendi i ditës.

-Vazhdojmë me miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar, e hap debatin, nëse nuk ka konstatojmë me (5) vota për, (0) kundër dhe (0) abstenim, miratohet Procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Vazhdojmë me piken 4 të rendit ditës:

- Informatë lidhur me ndryshimet në Zyrën Kadastrale, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër e Pronësi, me Nr.05-020/01-0009631/24, datë 13.02.2024, (Raporton),

**Drejtoresha e DGJKP-së, Blerta Dobra-Geci;** Fjala përshëndetëse, para vetes e keni Informatë lidhur me ndryshimet rrënjësore në Zyrën Kadastrale, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër e Pronësi, të cilat i ka parapa ligji i ri Nr.08/L-237, që tash veç ka hyrë në fuqi, që përmes këtij ligji do të bëhet një organizim vertikal institucional duke përfshirë zyrën kadastrale në kuadër të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Qytetaret këtu faktikisht do të përfitojnë, po ne si komunë do të humbasim një pjesë të te hyrave vetanake, mirëpo do të krijohen disa lehtësira sa i përket regjistrimit të pronës, mirëpo duke bashkëpunuar me agjensionin i kemi punuar 14 UA, në disa pjesë ku nuk jemi pajtuar me ligjin i kemi futur si ndryshime në UA, po gjithashtu duke mos i ikur bazës ligjore. Këto UA do të paraqesin ndryshime rrënjësore pra në formimin e komisioneve të reja, dhe nen komisioneve, ku komisioni kryesorë për rindërtimin e informacioneve ku ky komision do të krijojë lehtësira qytetarëve si në regjistrimin e pronës, në korrigjimin e të dhënave, ku në kataster këto telashe i kemi tash e sa kohe, për arsye së nuk kemi të dhëna të sakta të personave dhe pronave. Ky komision do të shkojë lagje në lagje, familje në familje, ku përmes deklaratës nen betim të cilën do ta nënshkruajnë edhe dy dëshmitar të cilët do të behet regjistrimi i pronës të cilat ato prona janë ble veç me pare në dorë. Punëtorët do të kalojnë në kuadër të Agjencisë dhe të menaxhohen nga agjencia po do të jenë në kuadër të institucionit, komunës i jesin vetëm punëtorët e sektorit të pronës, ju ftojë me përkrah.

**Kryesuesja:** E hap debatin, nëse nuk ka, Konstatohet me (4) vota për, (0) kundër dhe (1) abstënim rekomandohet për kuvend për miratim Informatë lidhur me ndryshimet në Zyrën Kadastrale, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër e Pronësi, me Nr.05-020/01-0009631/24, datë 13.02.2024.

Vazhdojmë me pikën 5 të rendit ditës:

Të ndryshëm, a ka dikush me shtua diçka, fjalën ja kaloj:

**Ilir Ejupi-IDEAL:** Fjala përshëndetëse, e kam një pyetje rreth përbërjes së KPF-së, a e keni planifikua që me bë zëvendësimin e anëtares së KPF-së në këtë seancë?

**Kryesuesja:** Po Ilir në këtë seancë behet zëvendësimi i anëtares së kuvendit, po ashtu edhe të anëtares së KPF-së, se e kemi marr vendimin nga KQZ-ja, dikush tjetër, nëse nuk ka, me kaq e mbyllim këtë mbledhje shihmi në seancë e kuvendit, me datë 29.02.2024, ora 10:00, gjitha të mirat.

Procesmbajtësi



Kryesuesja e Kuvendit